




Pranuar / Dorezuar / Prijmljeno / Pradato / Received / Delivery	11.01.2022	2	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jednica / Org. Unit	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPM/SHK	50/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1190/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtarë, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1128/2020 të datës 13.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative pranuar me date 16.12.2021 kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.151/2020 të datës 28.05.2020 të parashtruar nga ankuesi kundër

Vendimit me Nr.01-016/01-41188 të datës 18.05.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Pejës, në çështjen juridike “*ndërrprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.151/2020 e datës 28.05.2020, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.01-016/01-41188 i datës 18.05.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Pejës.

A r s y e t i m

Ndaj Akuesit i punësuar në Komunën e Pejës sipas Aktit të Emërimit me numër 02-112-66335 të datës 16.05.2016, në pozitën “Zyrtar Ligjor 2”, Kryetari Komunës së Pejës me datë 12.03.2020 pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda, në Pejë ka kërkuar nga Menaxheri i Personelit që të ndërmerren veprimet ligjore sipas Aktgjykimit DKR.P.nr.47/2018 të datës 19.12.2019 të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Pejë.

Pas pranimit të shkresës nga ana e Kryetarit të Komunës, zyra e menaxherit të Personelit i është drejtuar Komisionit Disiplinor për fillimin e procedurës disiplinore me shkresën zyrtare të datës 12.03.2020 ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Pejës ka pranuar shkresën më datë 25.03.2020 pasi që stafi i Komunës ka qenë duke punuar në mënyrë të reduktuar për shkak të masave të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me Covid-19.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Pejës me datë 15.04.2020 ka nxjerr vendim me numër 02-118/02-0037652/20, në të cilin vendim ankuesit _____ i shqipton masën disiplinore „ndërprerje e marrëdhënies së punës pa e dëmtuar apo reduktuar te drejtën në pension” .

Ankuesi _____ i pakënaqur me vendimin me numër 02-118/02-0037652/20 të datës 15.04.2020 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës me datë 23.04.2020 ka parashtruar ankese në KZAK të Komunës së Pejës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës me datë 18.05.2020 nxjerr Vendim me numër protokoll 01/016/01-41188 sipas të cilit vendim i refuzohet si e pa bazuar ankesa e datës 23.04.2020 e parashtruar nga ankuesi dhe mbetet në fuqi vendimi i Komisionit Disiplinor i Komunës së Pejës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoll 01-016/01-41188 të datës 18.05.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Pejës, të cilin e ka pranuar me datë 20.05.2020, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.05.2020 parashtron ankesën me numër protokoll 978/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 08.06.2020 ka dërguar kërkesë për përgjigjeje në ankesë në Komunën e Pejës, ndërsa me datë 23.06.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Pejës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 29.06.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 13.12.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1128/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 29.06.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 28.05.2020.



Administrimi i provave: Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 978/2020 të datës 28.05.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Parashtresë e datës 11.06.2020; Njoftim i datës 29.06.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 08.06.2020; Aktgjykim me nr. DKR.P.nr.47/2018 i Gjykatës Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Pejë i datës 29.10.2019; Shkresë me nr. PP/I-nr.140/17 i datës 15.04.2019; Vendim me nr. 01-016/01-41188 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 18.05.2020; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta i datës 15.01.2016; Akt Emërimi i datës 16.05.2016; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 16.05.2017; Aktvendim i datës 14.12.2017; Vendim me nr. 02-116/01-0025107/20 i Komisionit Disiplinor i datës 21.02.2020; Kërkesë për fillimin e procedurave disiplinore me nr. 02.016/01/35907 i datës 12.03.2020; Procesverbal i datës 14.04.2020; Vendim me nr. 02-118/02-0037652/20 i Komisionit Disiplinor i datës 15.04.2020; Ankesë drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës i datës 23.04.2020; Procesverbal i datës 12.05.2020; Pliko me nr. R8913535 i datës 09.06.2020; Përgjigje në ankesë e datës 23.06.2020; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta i datës 27.03.2014; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta i datës 01.08.2014; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta i datës 02.06.2015; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta i datës 15.01.2016; Aktvendim për fillimin e hetimeve PP/I Nr-140/2017 i datës 08.12.2017; Aktvendim i datës 14.12.2017; Kërkesë me nr.380/ZKA e datës 12.03.2020; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 16.03.2020; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore me nr. 02.016/01/35907 i datës 12.03.2020; E-mail nga E.SH. për A.U. i datës 16.03.2020; Kopja nga libri i Administratës 02/2020; Procesverbal i datës 26.03.2020; Kërkesë me nr. 01/016/01-36891 i datës 03.04.2020; Vendim me nr. 016/01-36981/2020 i datës 06.04.2020; Procesverbal i datës 14.04.2020; Vendim me nr. 02-118/02-0037652/20 i datës 15.04.2020; Zëvendësim i kryesuesit të komisionit i datës 06.05.2020; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 06.05.2020; Njoftim i datës 06.05.2020; Vendim me nr. 01/112/38925/2020 i datës 06.05.2020; Procesverbal i datës 12.05.2020; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës me nr. 01/016/01-41188 i datës 18.05.2020; Pliko me nr. R8978463 i datës 19.06.2020; Aktgjykimi A.nr.1128/2020 i datës 16.12.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Vendimi i Komisionit disiplinor është nxjerre jashtë afatit ligjor, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse me datë 16.03.2020, Zyra e Menaxherit të Personelit e ka përcjellë kërkesën lidhur me inicimin e procedurës disiplinore me numër 02-016/01/35907 tek Kryesuesi i Komisionit Disiplinor. Kolegji në bazë të dëshmisë se ofruar konkretisht nga kopja e librit të administratës ka konstatuar se Komisioni disiplinor kërkesën lidhur me inicimin e procedurës disiplinore me numër 02-016/01/35907 e ka pranuar më datë 23.03.2020, ndërsa Vendimin me numër 02-118/02-0037652/20 Komisioni Disiplinor e ka nxjerr më datë 15.04.2020, e që është brenda afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, përkatësisht me nenin 14 paragrafin3 ku përcaktohet se: *Faktet dhe dëshmitë për seanca disiplinore duhet të kompletohen*



sa më shpejt që është e mundur dhe komisioni duhet të marrë vendim brenda tridhjetë (30) ditëve prej lajmërimit të rastit”, rrjedhimisht në bazë të shkresave të lëndës pretendimi i ankuesit është i pabazuar pasi që Vendimi i Komisionit Disiplinor është nxjerrë brenda afatit ligjor dhe në pajtim me dispozitat disiplinore për shërbim civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankuesit i cili pretendon se ai është dënuar me dënim me kusht e jo dënim me burg efektiv, andaj organi i punësimit është dashur ti shqiptoj një mase më të lehtë e jo menjëherë ti ndërpresë marrëdhënien e punës, sepse sipas tij përfundimi i marrëdhënies se punës në mënyrë te prere behet nëse nëpunësi civil dënohet me burg efektiv mbi 6 muaj ashtu siç përcaktohet me nenin 90 paragrafin 2 nën paragrafin 2.4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjithnjë duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesi ka konstatuar se pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm sepse Komisioni Disiplinor i Komunës së Pejës me rastin e marrjes së Vendimit me numër 02-118/02-0037652/20 të datës 15.04.2020, duke u bazuar në Aktgjykimin DKR.P.nr.47/2018 të datës 19.12.2019 të Gjykatës Themelore/Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, „*ka shpallur fajtor ankuesin Budak Shala pasi që ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite dhe me dënim më gjorbë në të holla në shumë prej dyqindë (200.00) Euro, mirëpo dënimi me burg, fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që i akuzuari në afat prej një (1) viti nuk do të kryej vepër të re penale”,* ka vepruar në pajtim me të gjeturat e Aktgjykimit PKR.nr.273/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda të datës 19.12.2019, pasi që është vërtetuar se ankuesi me veprimet e tij lidhur me paraqitjen e rreme të fakteve dhe falsifikimin e dokumenteve ka bërë shkelje të detyrave të punës, andaj në këtë kuptim Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 63 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil”,* në pajtim me nenin 66 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil”* dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të dëshmive të ofruara dhe legjislacionit për shërbimin civil, respektivisht nenit 52 paragrafit 1, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se, „1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, nëpunësit civilë duhet të përkushtohen në zbatimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e interesit publik dhe jo në realizimin e fitimeve personale apo për individë apo organizata të tjera. 4. Nëpunësit civilë nuk do të shfrytëzojnë, për çfarëdo qëllimi, pozitën e tyre si përfaqësues të autoritetit publik për të detyruar apo për të kërkuar nga palët e treta ose kolegët dhe personeli të cilin e mbikëqyrin që të kryejnë punë, të bëjnë lëshime ose të marrin masa të jashtëligjshme ose që përbëjnë vepër penale. 5. Nëpunësit civilë, të cilët bëjnë shkeljen e këtij rregulli, do t'u nënshtrohen masave disiplinore administrative dhe ndjekjes penale nëse veprimet e tyre përbëjnë vepër penale ose nëse kanë nxitur palë të treta të kryejnë vepër penale” andaj meqenëse në rastin konkret ankuesi është shpallur fajtor dhe është dënuar për kryerjen veprës penale të mashtrimit


nga neni 335 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së sipas Aktgjykimin DKR.P.nr.47/2018 të datës 19.12.2019 të Gjykatës Themelore/Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, Kolegji konstaton se ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës, andaj në këtë kuptim Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „ndërprerje e marrëdhënies së punës pa e dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension“ ka vepruar në pajtim me nenin 67 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 nën nënparagrafin 1.2.4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.01-016/01-41188 i datës 18.05.2020, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Civil, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.1128/2020 të datës 13.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1190/2021

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarit .
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

REPUBLIC OF KOSOVA
MINISTRI I JUSTIÇIË
KOLLEGI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS